



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

Datë/a:	25.10.2021
Referenc-ë:	
Për/ Za/ To:	Drejtorinë e Kulturës
Përmes/Preko/Through:	Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit
Nga/ Od/ From:	Punoi: Liridona Kastrati, zyrtare për hapësira publike Kontrolloji: Habib Qorri, udhëheqës i sektorit
Tema/ Subjekat/Subject:	Pëlqim



Drejtoria për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtimit ka pranuar kërkesën përmes emailit zyrtar nga Drejtoria e Kulturës dhe Kushtrim Dushi të cilët në bashkëpunim me njëra-tjetrën për herë të parë kanë organizuar konferencë për skenën e muzikës nga data 02.11.2021 deri më 05.12.2021 ku do të vendosen shtande me dimension 1m gjerësi dhe 1.8 m lartësi në këto lokacione:

- Bulevardi “Nëna Terezë”, Benetoni;
- Sheshi “Skënderbeu” afër Soma Book Station”;
- Kinemaja ABC”;
- Sheshi “Zahir Pajaziti” afër Hotel Grandit.

Drejtoria pas shqyrtimit të kërkesës, duke u bazuar në nenin 4, pika 2, shkronjës i) të Rregullores për “Vendosjen, Ndërtimin dhe Largimin e Objekteve të Përkohshme në Pronën Publike” me nr.01-110-157481, jep pëlqimin Drejtorisë së Kulturës dhe Kushtrim Dushi për organizimin e konferencës për skenën e muzikës nga data 02.11.2021 deri më 05.12.2021 dhe vendosjen shtandeve me dimension 1m gjerësi dhe 1.8 m lartësi në lokacionet e kërkuara.

Kushtet e pëlqimit:

- Nuk lejohet dëmtimi i pronës publike dhe çdo dëmtim eventual si pasojë e këtij aktiviteti do të jetë përgjegjësi e juaja;
- Shtandi duhet të jetë i përforcuar mirë me qëllim që në raste që kemi erëra mos të paraqes rrezik për qytetarët;
- Të respektohen të gjitha masat dhe rregullat e përcaktuara nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës për organizimin dhe mbajtjen e aktiviteteve publike;
- Varësisht nga vendimet e IKSHP-së dhe Ministrisë për parandalimin e përhapjes së pandemisë, kushtet e pëlqimit mund të ndryshohen apo të bëhet pezullimi.

Vërejtje: pala është e obliguar që të respektojë të gjitha pikat e cekura më lartë, në të kundërtën pëlqimi konsiderohet i pezulluar.